



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor

Prof. Dr. Naser SAHITI

Nr. Prot.: 483

Datë: 8 / 4 / 2021

Për: Z. Hekuran Murati, ministër në Ministrinë e Financave dhe transfereve të Republikës së Kosovës

CC: Z. Salvador Elmazi, drejtor i buxhetit në MFT

Nga: Prof. dr. Naser Sahiti, rektor i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"

Lënda: **KASH 2022-2024**

I nderuar z. Murati,

Në bazë të shkresës e pranuar me datë 16.03.2021 nr. 01/356 nga Ministria e Financave në bazë të legjislacionit në fuqi si në vijim: Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Ligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, kemi përgatitur Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2022-2024 (KASH) sipas kufijve buxhetorë të lejuar në instruksionin e dhënë nga departamenti i buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Transfereve.

Kërkesa e universitetit është mbi kufijtë buxhetorë dhe shpresojmë t'i merrni në konsideratë.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

I. Misioni

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP) është institucion autonom publik për arsimin e lartë, që zhvillon arsimin akademik, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe fushat e tjera të veprimtarive akademike. UP ka për mision zhvillimin e një sistemi arsimor efektiv, që do t'i kontribuojë ngritjes së mirëqenies së shoqërisë, duke ofruar edukim dhe arsimim të barabartë për të gjithë qytetarët, cilësi të lartë në fushën e kërkimeve shkencore, inovacioneve dhe transferit të teknologjisë në pajtim me vlerat dhe standardet bashkëkohore duke respektuar diversitetin e një shoqërie demokratike dhe të prosperuar.

II. Situata aktuale

Universiteti i Prishtinës ka 14 njësi akademike, me mbi 33,000 studentë aktiv në aftësimin dhe përgatitjen e kuadrit adekuat për tregun e punës, kuadro të cilët ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e



ekonomisë së vendit. UP , si universitet publik, është bartës kryesor i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës dhe kontribuesi kryesor në arritjen e objektivave nacionale për rritjen e pjesëmarrjes në arsimin e lartë.

Me buxhetin e vitit 2020 është investuar kryesisht në infrastrukturë, siç janë disa renovime në të gjitha njësitë akademike, furnizimi me pajisje të teknologjisë informative sipas nevojave, investime në laboratorë të njësive akademike, parapagim i qasjeve në platforma shkencore, ndarja e bursave për student, mbështetja e stafit akademik në masë të vogël për punime shkencore etj. UP nuk ka arritur të këtë performance të mirë tek kategoria e shpenzimeve kapitale, sepse kjo varet nga faktorët e jashtë. Mirëpo, në masë të konsiderueshme ka ndikuar edhe situata e krijuar nga Pandemia COVID -19, pasi që gjatë vitit 2020 UP nuk ka mundur të realizojë pjesën më të madhe të investimeve kapitale të parapara me buxhetin e vitit 2020.

Një nga objektivat kryesore për Universitetin e Prishtinës mbetet thellimi dhe vazhdimi i bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe harmonizimi i plan-programeve me standardet evropiane. Gjatë vitit 2020, UP nuk ka mundur të këtë bashkëpunim të frytshëm ndërkombëtar shkaku i krizës së shkaktuar nga Pandemia COVID-19.

Pavarësisht këtyre rezultateve UP përballet me këto sfida:

- Mungesën e hapësirave për studim,
- Numrin e madh të studentëve,
- Kërkesën për laboratorë dhe pajisjeje të IT-së,
- Renovime në objektet e vjetra,
- Arritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie,
- Avancimi dhe shtimin e stafit akademik.

Objektivat

Për të realizuar misionin e vet, UP për periudhën afatmesme 2022-2024, ka këto objektiva:

1. Ngritjen e cilësisë në studime dhe mësimdhënie;
2. Avancimin e kërkimeve shkencore në UP dhe shndërrimin e Universitetit në institucion të arsimit të lartë dhe hulumtimeve shkencore;
3. Zgjerimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së UP-së duke përfshirë objektet, laboratorët dhe TI

Objektivi i parë - synon të bëjë ngritjen e cilësisë në studime, mësimdhënie dhe mësimnxënie si dhe në hulumtime shkencore sipas normave që kërkohen. Realizimi i këtij objektivi planifikohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Organizimin e Universitetit Veror të Prishtinës;
- Sigurimin e përfshirjes më të madhe të gjeneratës së re në arsimin e lartë, në harmoni me kërkesat e tregut të punës;
- Ngritjen e cilësisë në studime, mësimdhënie, mësimnxënie dhe avancim të kërkimeve shkencore

Objektivi i dytë - synon avancimin e kërkimeve shkencore, shndërrimin e Universitetit në institucion të arsimit të lartë dhe të hulumtimeve shkencore. Realizimi i këtij objektivi planifikohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Integrimi dhe ndërkombëtarizimi i UP-së në proceset zhvillimore ndërkombëtare të kërkimeve shkencore për zgjidhjen e problemeve të shoqërisë dhe në shërbim të ekonomisë;
- Rritja e lëvizshmërisë së mësimdhënësve, hulumtuesve dhe studentëve (Mobilitetet) ;
- Avancimi i kërkimeve shkencore në UP dhe shndërrimi i Universitetit në institucion të arsimit të lartë dhe hulumtimeve shkencore;
- Rritja e numrit të bibliotekave me literaturë shkencore;
- Hartimi i politikave për sigurim të cilësisë, certifikim, vlerësim, standarde dhe kualifikime.

Objektivi i tretë - eliminimin e mungesës së hapësirave në UP si dhe arritjen e standardeve në nivel me universitetet e rajonit dhe më gjerë. Realizimi i këtij objektivi planifikohet të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:

- Përmirësimi i ambientit të përgjithshëm arsimor në institucionet e arsimit të lartë përmes investimeve në infrastrukturën fizike të institucioneve;
- Krijimi, avancimi dhe zhvillimi i sistemit informativ në të gjitha fushat e shërbimeve në UP;
- Zgjerimin e hapësirave të reja në UP përmes ndërtimit të objekteve të reja
- Investimet në laboratorët e UP-së në teknologji të re dhe të fundit sipas trendëve ndërkombëtare dhe inovative.
- Zgjerimi i hapësirave në objektin e Laboratorëve të fakulteteve teknike (ndërtimi i Qendrës së Inovacionit)
- Mbindërtimi i kulmit të objektit në fakultet teknike dhe integrimi i sistemit inovativ me energji të ripërritëshme (Solare), ku do të bëhej e mundur edhe pavarësimi i këtij objekti nga rrjeti elektrik
- Renovimi i sallës së Fakultetit Filologjik (kycja në ngrohje nga Termokosi, Ventilimi, Ndiçimi, Nyjat sanitare dhe korridori)

Tabela nr. 1 - Trendët e financimit 2018-2021 dhe vlerësimet 2022-2024

Organizata buxhetore	Viti 2018 shpenzuar	Viti 2019 Buxhetuar	Viti 2020 Buxhetuar	Buxheti 2021	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar
Total	29,513,418	34,785,502	34,927,725	31,012,524	32,379,244	32,485,227	34,887,397
Numri i punëtorëve	2081	2081	2081	2081	2081	2081	2081
Paga	20,887,326	21,263,857	20,986,212	21,091,143	21,106,863.00	21,212,397.32	22,162,397
Mallra dhe shërbime	3,525,428	3,402,645	3,422,513	3,302,381	3,302,381.00	3,302,829.68	3,650,000.00
Shpenzime komunale	987,256	1,175,000	1,175,000	1,175,000	1,170,000.00	1,170,000.00	1,175,000
Subvencione dhe transfere	740,816	1,444,000	1,444,000	1,444,000	1,400,000.00	1,400,000.00	1,500,000
Shpenzime kapitale	3,372,592	7,500,000	7,900,000	4,000,000	5,400,000.00	5,400,000.00	6,400,000

Burimet e financimit	29,094,735	34,785,502	34,927,725	31,012,524	32,379,244	32,485,227	34,887,397
Grantet qeveritare	25,001,073	26,787,752	30,929,975	31,120,394	29,529,201.50	29,635,184.50	32,037,354.82
Financimi nga të hyrat e AKP-së	879,786	4,000,000					
Të hyrat vetanake	3,213,876	3,997,750	3,997,750	3,997,750	2,850,042.50	2,850,042.50	2,850,043
Financimet nga huamarrjet		-	-	-			-
Financimi nga deficitit buxhetor (2%) - 04							
Financimi nga Klauzola e investimeve -06							
Grantet nga Donatorët *							

Në kategorinë e shpenzimeve për paga dhe mëditje – janë planifikuar mjetet për stafin aktual dhe numrin e stafit të aprovuar ndërsa pa buxhet shtesë nuk mund që të ketë rritje të stafit, të cilësisë në arsim dhe zvogëlimin e raportit student profesor i cili është i lartë krahasuar me standardet ndërkombëtare. Prandaj, UP në Planin tre vjeçar ka për synim që të zvogëlojë numrin e profesorëve të angazhuar si dhe uljen e pagesave për mbi normë tek stafi akademik, si dhe përmirësimin e shërbimeve për student. Mirëpo, për të arritur këtë synim UP-së i duhen mjete shtesë në tre vitet e ardhshme pasi që kjo sjellë edhe rekrutim të stafit të ri. Vlera e buxhetit shtesë të nevojshëm është paraqitur në tabelën nr. 2.

Në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbimeve - do të mbulohen vetëm shpenzimet fikse. Me kufirin e lejuar nuk do të ketë buxhet për ti realizuar të gjitha aktivitetet shkencore të njësive akademike dhe instituteve të cilat duhet të bëjnë kërkime shkencore dhe hulumtime sipas planit të punës konkurruese në treg. UP me strategjinë zhvillimore e ka të paraparë buxhetin për shkencë vetëm 1 % nga vlera e përgjithshme e buxhetit vjetor të UP-së dhe UP vazhdimisht ka munges të buxhetit për mbulimin e shpenzimeve në këtë kategori dhe çdo here në përmbyllje të vitit fiskal ka pasur kërkesa shtesë për mjete drejtuar MF-së dhe qeverisë për mbulimin e shpenzimeve. Në mënyrë që të mos kemi probleme të tilla, UP kërkon që edhe kjo kategori buxhetore të ketë buxhet shtesë sipas vlerës së paraqitur në tabelën nr. 2.

Në kategorinë e shpenzimeve komunale - do të realizohen të gjitha obligimet që ka UP-ja.

Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe transfere - mjetet e planifikuara janë të mjaftueshme për zbatimin e politikave bazë në UP; për mbështetjen e stafit akademik si dhe publikime shkencore dhe mobilitet pasi që me Statutin e UP-së stafi është i obliguar të publikojë punime në revista me renome, e të cilat kanë një kosto të lartë.

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale - mjetet buxhetore nuk janë të mjaftueshme për realizimin e objektivave strategjike në kuadër të kësaj kategorie. Një pjesë e investimeve shtesë të nevojshme në këtë kategori janë si vijon:

- Zgjerimi i hapësirave në objektin e Laboratorëve të fakulteteve teknike (ndërtimi i Qendrës së Inovacionit)

- Mbindërtimi i kulmit të objektit në fakultet teknike dhe integrimi i sistemit inovativ me energji të ripërtritëshme (Solare), ku do të bëhej e mundur edhe pavarësimi i këtij objekti nga rrjeti elektrik
- Renovimi i sallës së Fakultetit Filologjik (kyçja në ngrohje nga Termokosi, Ventilimi, Ndryçimi, Nyjat sanitare dhe korridor)

Duke u bazuar në specifikat që ka UP dhe nevojave imediate në këtë kategori ekonomike duhet të rritet buxheti i UP-së edhe për nga 1.5 milion € në tri vitet në e ardhshme.

Andaj duke respektuar vlerësimet e MFT-së për vitet 2022-2024, ne kërkojmë që UP-së ti rritet buxheti për realizimin e politikave bazë siç janë cekur në vijim në tabelën nr. 2.

Tabela nr. 2 - Kërkesat e UP-së për mjete shtesë për periudhën KASH 2022-2024

Politika e re prioritare 1.	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar
Përshkrimi :			
Ndërlidhja e politikës së re me Dokumentet Strategjike			
Total:	3,460,315.00	4,453,195.25	5,304,235.25
Numri i punëtorëve			
Paga dhe mëditje	1,134,720.00	2,127,600.00	2,978,640.00
Mallra dhe shërbime	825,595.00	825,595.25	825,595.25
Shpenzime komunale			
Subvencione dhe transfere			
Shpenzime kapitale	1,500,000.00	1,500,000.00	1,500,000.00
Burimet e financimit			
Grantet qeveritare	3,460,315	4,453,195	5,304,235

Me mjetet shtesë do të financohen këto shtyllat kryesore strategjike bazë si në vijim:

- **Rritja cilësisë në Arsim, Universitet dhe Studime** - Stimulimin e kuadrit mësimdhënës me kualifikime të doktoraturës në 10 vitet e ardhshme. Zhvillimin dhe zbatimin e një modeli të ri të rekrutimit të stafit akademik i cili do të jetë globalisht konkurrues në mësimdhënie, hulumtim dhe të shërbimeve në UP për të arritur statusin e një institucioni të arsimit të lartë që renditet në mesin e institucioneve më të mira në mbarë botën deri në vitin 2027.
- **Nxitja e Ekselencës Kërkimore** - Të mbështesim misionin tonë kërkimor duke rritur financimin institucional dhe shpenzimet kërkimore me 1% çdo vit; të ofrojmë investime me shënjestër kërkimin më të avancuar dhe punën krijuese. Krijimi i një qendre dhe menaxhimi për hulumtim, mbështetje kërkimore dhe menaxhim të fondeve nga jashtë (granteve) e cila ka filluar të ngritet në vitin 2017 në ZKPS.
- **Mbështetja e misionit** - Rritja e stafit të Universitetit për të mbështetur arsimin, kërkimin dhe punën krijuese, shërbimet dhe veprimet. Zhvillimi, zbatimi dhe sigurimi i një përmirësimi të vazhdueshëm në të gjitha shërbimet e UP-së nëpërmjet të standardeve ndërkombëtare të

kontrollit të cilësisë dhe akreditimit duke plotësuar kriteret ndërkombëtare në lidhje me raportin mësimdhënës-student.

- **Të mësuarit për një botë me diversitet** - Zbatimi i strategjive të reja për përmirësimin e diversitetit; nxitjen e një klime mbështetëse dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë.
- **Globalizimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve akademike** dhe shërbimeve studentore të fakulteteve të UP-së për të nxitur shkëmbimin maksimal dhe lejimin e kompetencave përtej kufijve.

Planifikimi i të hyrave

UP në tri vitet e fundit ka investuar në laboratorët e fakulteteve teknik dhe në laboratorët e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë. Gjithashtu, në vitin 2021 ka synim që të vazhdojë investimin në këto laboratore në mënyrë që të gjenerojë të hyra nga partneriteti me ekonominë. Po ashtu, është planifikuar inkasimin i të hyrave nga pagesat e studentëve në bazë të UA 17/2014. Në vijim në tabelën nr. 3 është paraqitur planifikimi i të hyrave për vitet 2022-2024.

Tabela nr. 3 - Plani i të hyrave për vitet 2022-2024

Përshkrimi i të hyrave	Viti 2020 Arkëtuar	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar
Totali:	2,614,986	3,997,750	2,850,043	2,850,043	2,850,043
Të hyrat nga pagesat e studentëve sipas UA 17/2014	2,574,234.27	3,181,674.00	2,025,042.50	2,025,042.50	2,025,042.50
		<i>Universiteti i Prishtinës inkason të hyra në bazë të UA 17/2014 dhe ky planifikim është bërë mbi bazën e numrit aktual të studentëve. Po ashtu, të hyrat e UP-së janë pjesë e buxhetit dhe shfrytëzohen sipas 5 kategorive ekonomike.</i>			
Te hyrat nga shitja e shërbimeve(Institut)\	40,751.50	816,076.00	825,000.00	825,000.00	825,000.00
		<i>Universiteti i Prishtinës aktualisht ka dy institutet që gjenerojnë të hyra nga shitja e shërbimeve, por shumë shpejtë pritet që të krijohen edhe disa institute të reja pasi në vitet e kaluara është investuar në laboratorët e fakulteteve teknike dhe të Fakultetit të Bujqësisë. Po ashtu, edhe gjatë vitit 2020 janë të buxhetuara mjetet për blerjen e pajisjeve në këto fakultete dhe UP do të jetë e gatshme që të funksionalizojë këta laboratorë për punë me ekonomi</i>			

Duke u bazuar në numrin aktual të studentëve si dhe në inkasimin e të hyrave në vitin 2020 është ulur planifikimi i të hyrave dhe është bërë sipas numrit aktual të studenteve. UP planifikon që gjatë vitit 2022 të inaksojë të hyra në vlerë 2,850,043.00 euro, gjë që do të thotë se UP ka ulur

planifikimin e të hyrave për vitin 2022 në vlerë 1,147,707.00 euro. Prandaj, kërkojmë nga MF që kjo shumë të rritet nga burimit i financimit në fondin numër 10 (BKK), duke ruajtur kufijtë aktual të shpenzimit, por gjithashtu edhe duke pasur në konsideratë kërkesat shtesë të UP-së për mjete të prezantuara tabelën nr.2.

Me respekt,



Rektori i UP-së:

Prof. Dr. Naser Sahiti

N. Sahiti